



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**ZL.Anr.509/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesat e kandidatës për anëtarë të Kuvendit Komunal në Kamenicë, Besa Krasniqi nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Kamenicë, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.10.2017, mori këtë:

### **V E N D I M**

**HUDHEN** si të palejuara ankesat: ZL.A.nr.509/2017 dhe ZL.A.nr.510/2017, të kandidatës për anëtarë të Kuvendit Komunal në Kamenicë, Besa Krasniqi nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Kamenicë, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

### **A r s y e t i m**

Me datën 25.10.2017, PZAP-i ka pranuar 2 (dy) ankesa nga Besa Krasniqi, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal të Kamenicës, nga radhët e subjektit politik LDK, me të cilat pretendon se i janë keqpërdorur votat, në Fshatin Shipashnicë, të Komunës së Kamenicës, në vendvotimet: 1008D/01R dhe 1008D/02R, si dhe në Fshatin Roganë në vendvotimet: 1009D/01R, 1009D/02R, 10090/03R, 1009D/04R.

Paneli, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me ZL.Anr.509/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të dy ankesat vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesave, gjeti se:

#### **Ankesat janë të pa lejuara**

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesat e parashtruara përkitazi me manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesa, për faktin se shkeljet që ndërliidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrihen pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi, për shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj paneli vendosi që ti hudh si të parakohshme ankesat e ankueses. Hudhja e ankesave të ankueses Besa Krasniqi, nuk e paragjykon çështjen dhe asaj nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesë tjetër, pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa**  
ZL. Anr.509/2017 me datën 25.10. 2017.



**Kryesuese e Panelit**  
Gyltene Sylejmani

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*